

VENDIM
Nr. 394, datë 19.6.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 224, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në numrat rendorë 10, 11 e 12, niveli 3, të lidhjes nr. 5, që përmendet në pikën 5, të vendimit nr. 224, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjala “Kompanitë ...” zëvendësohet me fjalët “Kompania e Parë, e Dytë dhe e Tretë e Këmbësores ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe